



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština –Municipality of Prishtina

<b>Datë/a:</b>	11.06.2021
<b>Referenc-ë:</b>	
<b>Për/ Za/ To:</b>	“CRPK”
<b>Përmes/Preko/Through:</b>	Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit
<b>Nga/ Od/ From:</b>	Punoi: Liridona Kastrati, zyrtare për hapësira publike Kontrolloi: Habib Qorri, udhëheqës i sektorit
<b>Tema/ Subjekat/Subject:</b>	Pëlqim

Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim ka pranuar kërkesën përmes emailit zyrtar nga “CRPK” në bashkëpunim me “UNHCR” me të cilën kërkohet shfrytëzimi i hapësirës publike në parkun e Gërmisë me datë 16 Qershor 2021 nga ora 12:00 deri në ora 14:00.

Qëllimi i kërkesës është shënimi i Ditës Botërore të Refugjatëve ku do të organizohet piknik për fëmijët azilkërkues, refugjatë dhe fëmijët e komunitetit pritës.

Drejtoria pas shqyrtimit të kërkesës, duke u bazuar në nenin 4, pika 2, shkronjës i) të Rregullores për “Vendosjen, Ndërtimin dhe Largimin e Objekteve të Përkohshme në Pronën Publike” me nr.01-110-157481, jep pëlqimin për shfrytëzimin e hapësirës publike për shfrytëzimin e hapësirës publike në parkun e Gërmisë me datë 16 Qershor 2021 nga ora 12:00 deri në 14:00 sipas kërkesës së parashtruar.

Kushtet e pëlqimit:

- Të respektohen të gjitha masat dhe rregullat e përcaktuara nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës për organizimin dhe mbajtjen e aktiviteteve publike;
- Varësisht nga vendimet e IKSHP-së dhe Ministrisë për parandalimin e përhapjes së pandemisë, kushtet e pëlqimit mund të ndryshohen apo të bëhet pezullimi.

Vërejtje: pala është e obliguar që të respektojë të gjitha pikat e cekura më lartë, në të kundërtën pëlqimi konsiderohet i pezulluar.